



**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni pranveror**

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 15.**

**Prishtinë, më 7.07.2015 në ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jasmina Živković, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Milka Vuletić, Saša Milosavljević, Slavko Simić, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

**Munguan:** Agim Çeku, Rustem Berisha dhe Çerim Bajrami

**Emrat e pjesëmarrësve në mbledhje :** përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

**Emrat e stafit mbështetës të komisionit,** Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-27 për Dixhitalimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiëkqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë, me amandamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiëkqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-246 për Paisje me Armë, Municion dhe paisje përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, me amandamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiëkqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;**
9. **Të ndryshme.**

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesja**, theksoi se agjenda për ditën e sotme është caktuar në bazë të vendimit të Kryesisë e cila obligon Komisionin të shqyrtohen projektligjet në procedurë të përshpejtuar, në mënyrë që rekomandimet t'i dërgohen me kohë Komisioneve Funksionale.

Mendon se duhet të tërhiqet e vetmja pikë e rendit të ditës - shqyrtimi i Projektligjit për Letërnjoftim nga se në raportin e komisionit funksional janë të bashkangjitura edhe propozim amandamentet e deputetit Nait Hasani, me tekst që të shtohet fjala 'nacionaliteti', andaj për të bërë analizë më të detajuar, kërkohet afat shtesë.

Kryesuesja, hapi debat me qëllim që anëtarët e komisionit të deklarohet nëse ka ndonjë propozim konkret për procedim të mëtejshëm në projektligjet e lartëcekura.

**Myfera Sinik** – mendon se shqyrtimi i projektligjeve siapas agjendës së ditë së sotme ka ardhur në procedurë të përshpejtuar e cila paraqet ngarkesë të madhe për ne.

Edhe pse nuk jemi komision funksional lidhur me projektligjet e lartëcekura, nuk do të thotë se përgjegjësia nuk bie në komisionin tanë pasi të njëjtat duhet të shqyrtohen dhe anaëlizohen nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Këto janë arsyet e saja për mos miratimin e të njëjtave.

**Saša Milosavljević**, diskutoi lidhur me çështjen e procedurave të shqyrtimit të projektligjeve me amandamentet e komisioneve funksionale dhe mendon se koha është shumë e shkurtër për të dhënë vlerësime detajuese. Mirëpo, është i pajtimt që komisioni të repsektojë procedurat e votimit të projektligjet në pako.

**Milka Vuletic** – jemi në dijeni se komisioni duhet të përmbahet procedurave të përshpejtuara, sidomos kur bëhet fjalë për projektligjet të cilat janë në harmoni me legjislacionin dhe nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Andaj, pajtohet me parafolësit që projektligjet të votohen në pako.

**Agim Kikaj** – në fjalën e tij tha se projektligjet e propozuara janë miratuar në lexim të parë në Kuvend andaj sot komisioni duhet të votojë dhe procedojë në procedurë të mëtejshme pasi të njëjtat nuk bien në ndesh me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

**Fisnik Ismaili** – si detyrë dhe përgjegjësi kryesorë e komisionit është të punojë me përgjegjësi të shtuar, me qëllim që ligjet të janë të zbatueshme për qytetarët edhe duke mos përjashtuar mundësinë që të ofrojmë përkrahje komuniteteve. Konsideron se shqyrtimi i projektligjeve me raporte të komisioneve funksionale në procedurë të përshpejtuar na hendikepojnë mundësinë e dhënjes së opinionëve reale. Për këto arsye nuk do të jep pëlqimin për miratim të projektligjeve të lartëcekura.

Pas diskutimeve të anëtarëve, **kryesuesja** konstatoi se miratohet rendi i ditës në pajtim që projektligjet të votohen në pako.

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

**Kryesuesja**- paraqet për shqyrtim Projektligjin Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim dhe nxori këtë:*

### **P ë r f u n d i m**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-28 për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

*Pas shqyrtimit të Projektligjit Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim, dhe nxori këtë:*

### **P ë r f u n d i m**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L-29 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**

*Pas shqyrtimit të Projektligjit Nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim, dhe nxori këtë:*

### **P ë r f u n d i m**

- III. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L-37 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-27 për Dixhitalimin e transmetimeve radio difuzive tokësore, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**

*Pas shqyrtimit të Projektligjit Nr.05/L-27 për Dixhitalimin e transmetimeve radio difuzive tokësore dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim dhe nxori këtë:*

**P ë r f u n d i m**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr.05/L-27 për Dixhitalimin e transmetimeve radio difuzive tokësore dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**6. Shqyrtimi i Projektligjit 05/L-15 për Letërnjoftim, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiëkqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;**

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe propozim amendamentet e deputetit Nait Hasani .

*Pas diskutimeve të anëtarëve, Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim dhe nxori këtë:*

**P ë r f u n d i m**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-15 për Letërnjoftim dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- III. Gjithashtu, Komisioni shqyrtoi amendamentet e deputetit Nait Hasani dhe të njejtat nuk i miratoi.

**7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë, me amendamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiëkqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;**

*Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit Nr. 05/L-22 për Armë dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim, dhe nxori këtë:*

## **P ë r f u n d i m**

- V. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 05/L-22 për Armë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- VI. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

### **8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 03/L-246 për Paisje me Armë, Municion dhe paisje përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri, me amandamente të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbiëkqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës;**

*Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit Nr. 03/L-246 për Paisje me Armë, Municion dhe paisje përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, miratoi Projektligjin me rezultat të votimit, pesë (5) për, katër (4) apstenim, dhe nxori këtë:*

## **P ë r f u n d i m**

- VII. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin Nr. 03/L-246 për Paisje me Armë, Municion dhe paisje përkatëse të Sigurisë për Institucionet e Autorizuara Shtetërore për Siguri dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- VIII. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

### **9. Të ndryshme**

**Kryesuesja** – propozoi që në mbledhjet e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të ftohen përfaqësuesit e UNHCR, për të dhënë mbështetjet e tyre lidhur me çështjet aktuale që zhvillon Komisioni.

*Me propozimin e Jasmina Živkovic, u pajtuan anëtarët e Komisioni dhe njëzëri nxorri këtë:*

## **Përfundim**

*Në mbledhjet e rregullta të Komisionit do të ftohen përfaqësuesit e organizatës së UNHCR-së në pajtim me afatet kohore të Komisionit.*

**Mbledhja përfundoi në orën 12:30**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetare e Komisionit**

---

**Jasmina Živković**